



VENDIM

Nr. 16 Datë 28.02.2011

PËR

**MBYLLJEN E PROÇEDIMIT ADMINISTRATIV PËR SHOQËRINË
“BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP” SH.P.K, LIDHUR
ME KËRKESËN PËR MARRJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, dhe neneve 99 dhe 101, pika 1, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurës Administrative”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.02.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga subjekti “Balkan Finance Investment Group” sh.p.k, për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe më pas kërkesën për tërheqje nga aplikimi për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Vendosi:

1. Të mbyllë proçedimin administrativ për shoqërinë “Balkan Finance Investment Group” shpk, lidhur me kërkesën për marrjen e statusit të Klientit të Kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojnë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 16 Datë 28.02.2011

PËR

**MBYLLJEN E PROÇEDIMIT ADMINISTRATIV PËR SHOQËRINË
“BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP” SH.P.K, LIDHUR
ME KËRKESËN PËR MARRJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____